

## NJOFTIM

Për: Z/Znj. \_\_\_\_\_ (Aksioner/Perfaqesues/e i/eAksionerit \_\_\_\_\_)

Per ndryshimin e rendit te ditës te mbledhjes se Asamblesë se Aksionareve date 20 qershor 2024, sipas kërkesës se paraqitur nga Drejtoria ne përputhje me Nenin 139 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare». Pas kësaj kërkesë, rendi i ditës se mbledhjes date 20 qershor 2024 behet si me poshtë:

1. Propozim për miratimin e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, znj. Vera Fazlli LALA, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksioner të shoqërisë "CREDINS BANK" SH.A. nëpërmjet kalimit te fitimit te vitit 2023.
2. Vendimmarrje e Aksionerëve të Bankës Credins lidhur me aksionet ende të panënshkruara të emetuara me Vendimin nr. 03/5, datë 29.06.2023 të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë "Banka Credins" Sh.a.
3. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme te Jashtëzakonshme te Aksionareve te Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive qe do te zhvillohet me rend dite si me poshtë:
  1. Mbi miratimin e krijimit të Fondit të Investimit Alternativ "Credins Global Bonds" dhe dokumentacionit përkatës të tij, i cili konsiston në miratimin e:
    - Prospektit të Fondit të Investimit Alternativ "Credins Global Bonds"
    - Dokumentit "Programi i veprimtarisë" së Fondit të Investimit Alternativ "Credins Global Bonds"
    - Dokumenti "Pasqyra e masave" të Fondit të Fondit të Investimit Alternativ "Credins Global Bonds"
    - Dokumenti "Kërkesë për blerje kuotash në Fondin e Investimit Alternativ Credins Global Bonds"
    - Depozitarit të Fondit të Fondit të Investimit Alternativ "Credins Global Bonds", shoqërinë American Bank of Investments, si dhe tekstin e draft kontratës me depozitarin.
    - Auditit të pavarur dhe ekspertit kontabël të autorizuar, për auditimin e pasqyrave financiare të Fondit të Investimit Alternativ "Credins Global Bonds", shoqërinë "RSM ALBANIA" SH.P.K. (auditues ligjor), për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2024, si dhe tekstin e draft kontratës që do të lidhet me Audituesin e pavarur.
  2. Mbi miratimin e krijimit të Fondit të Investimit me ofertë publike, me pjesëmarrje të hapur "Credins Dynamic" dhe dokumentacionit përkatës të tij, i cili konsiston në miratimin e:

- Prospektit të Fondit të Investimit "Credins Dynamic"
- Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin (KIID) të Fondit të Investimit "Credins Dynamic"
- Depozitarit të Fondit të Fondit të Investimit "Credins Dynamic", shoqërinë "American Bank of Investments", si dhe tekstin e draft kontratës me depozitarin.
- Auditit të pavarur dhe ekspertit kontabël të autorizuar, për auditimin e pasqyrave financiare të Fondit të Investimit "Credins Dynamic, shoqërinë "RSM ALBANIA" SH.P.K. (auditues ligjor), për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2024, si dhe tekstin e draft kontratës që do të lidhet me Audituesin e pavarur.

5. Ngarkohet Drejtoria te beje njoftimet dhe regjistrimet perkatese ne perputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

**Martin KORKUTI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



Tirane me 12.06.2024

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»
- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
  - a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;
  - b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».
- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.
- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.
- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.
- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.
- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.